

01-1738 11.06.2010

PRIŠTINA - PRIŠTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.

HYDRO-ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Priština, Kosovo

Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: iber\_lepenci@hotmail.com

**RREGULLORE PËR KOMPENZIMET JASHTË PAGËS  
BAZË  
DHE REPREZENTACIONIT**

PRISHTINË, MAJ 2010

## **RREGULLORE PËR KOMPENZIMET JASHTË PAGËS BAZË DHE REPREZENTACIONIT**

### **Neni 1 Kompenzimi i pagës bazë**

Përveç kompensimit të pagës bazë, të paraparë me Ligj, Punëmarrësit e kësaj Ndërmarrje gjëzojnë të drejtën edhe në këto kompenzime shtesë:

1. Në emër të punës së kaluar, Punëmarrësve paga bazë iu ngritet për 0,5%, për çdo vit të punës së kaluar, pas përfundimit të vitit të parë të përvojës së punës;
2. Në emër të punës së kaluar kompenzimi kufizohet në 40 vite përvojë pune, përkatësisht 20%, nga paga bazë;
3. Në emër të shujtës së ngrohet, punëmarrësve iu jepen deri në 3 € në ditë, për çdo ditë pune duke përfshirë edhe ata me rindarje të orarit;
4. Në emër të efektivitetit, azhuritetit dhe disiplinës në punë, punëmarrësit, me propozim të udhëheqësve të tyre mund të shpërblehen nga Kryeshefi Ekzekutiv deri në 10% të pagës bazë, bazuar në efektshmërinë e tij pas vlerësimit mujor apo periodik nga udhëheqësit e tyre;
5. Shpërblimi paraprak duhet ta ketë bazën në Planin e buxhetit të Ndërmarrjes;
6. Me rastin e rezultateve të jashtëzakonshme të arritura nga njësi të veçanta, apo Ndërmarrja, të treguara në periudha të caktuara apo gjatë vitit afarist me rritjen e të hyrave, zvogëlimit të shpenzimeve dhe kursimeve, ku për rrjedhojë Ndërmarrja afaron me fitim, Kryeshefi Ekzekutiv mund t'i shpërblejë punëtorët apo njësitë e veçanta, apo Ndërmarrjen në tërsi në formë bonusi në përqindje të fitimit të realizuar deri në lartësinë e një page mujore për punëtor. Shpërblimit paraprak duhet t'i paraprijë pëlqimi i Bordit të Drejtorëve;
7. Në raste të sëmundjeve jashtëzakonisht të rënda të punëmarrësve, që kërkojnë trajtim të gjatë mjekësor (mbi 30 ditë pune), përjashtimisht, deri në rregullimin institucional të sigurimeve shëndetësore, me Vendim aprovues të KE pas analizimit të gjithanshëm të rastit konkret, të argumentuar me prova materiale (dëshmi mjekësore), lejohet kompenzimi deri në 80 % të pagës bazë, dhe një ndihmë solidare financiare me qëllim të participimit në mbulimin e shpenzimeve të shërimit, varësish nga rastet veç e veç, maksimalisht deri në 2000 € (dy mijë euro);
  - 7.1. Ndërrmarja, mund të jetë donatorë, përkatësisht të participojë në mbulimin e shpenzimeve humanitare të personave fizik apo OJQ-ve, siç janë shpenzimet e shërimit, strehimit, aktiviteteve kulturore, sportive, dhe të ngashme, maksimalisht deri në 2000 € (dy mijë euro);

8. Me rastin e pensionimit, punëtori do të shpërblehet me 3 paga mesatare të realizuara gjatë 3 muajve të fundit dhe një orë dore;
9. Me rastin e vdekjes së punëtorit, bashkëshortit-es ose pasardhësve iu jepet ndihma e njëhershme materiale në lartësi prej 1000 € (një mijë euro);
10. Shpenzimet në emër të udhëtimeve zyrtare do të kompenzohen në pajtim me Udhëzimet Administrative të institucioneve të Republikës së Kosovës, për udhëtimet zyrtare, me propozim të udhëheqësit të njësisë përkatëse, i lejon Kryeshefi Ekzekutiv.

**Neni 2  
Reprezentacioni**

- (1) Në emër të përfaqësimit (reprezentacionit) nga bufeja e Ndërmarrjes, stafi drejtues i Ndërmarrjes, ka të drejtë të harxhimit deri në 40 € në muaj.
- (2) Në emër të përfaqësimit (reprezentacionit), jashtë Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes ka të drejtën e harxhimit (për dreka zyrtare) deri në 9.000 € (nëntë mijë euro) në vit, ndërsa zyrtarët e lartë, dhe drejtorët e njësive “Uji dhe Centrali Elektrik” si dhe “Ujitja” kanë të drejtën e harxhimit (për dreka zyrtare) deri në 1.200 € (një mijë e dyqind euro) në vit.
- (3) Në emër të përfaqësimit të Ndërmarrjes me rastin e festës së Vtitit të Ri (kalendar, fletore, lapsa etj., stafi drejtues i Ndërmarrjes, ka të drejtën e shpenzimeve të përbashkëta deri në 9.500 € (nëntë mijë e pesëqind euro) në vit.

**Neni 3**

Kompensimet përtej pagës bazë mund të realizohen nëse paraprakisht janë të aprovuara me Planin e Buxhetit.


**Neni 4  
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefi Ekzekutiv të Ndërmarrjes

**31.05.2010**

**Kryeshefi Ekzekutiv**

**Hajdar Beqa**



**3**

